



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 55 Prot

Tiranë, më 17, 04, 2012

VENDIM Nr. 189, dt. 17.04.2012

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 17.04.2012, pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv sipërfaqësor në HEC-et e Kaskadës së Devollit, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik mbi bazën e kërkesës së Subjektit "Devoll Hydropower sh.a.",

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv sipërfaqësor në HEC-et e Kaskadës së Devollit, Subjekti "Devoll Hydropower sh.a.", realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me DRKK-të, ZAKPA dhe Konsulencë shkencore IA (QSA).
- II. Kryerjen e sondazheve arkeologjikë në traktet e përcaktuara gjatë vëzhgimit intensiv arkeologjik, si më poshtë:
 - **Site 2**, Vendbanim i hapur i periudhës romake (ndodhet në traktet B – 61).
 - **Site 3**, Prezencë qeramike bronzi me rrënë, fragmente të periudhës së hekurit, qeramikë të periudhës helenistike dhe otomane.
(Ndodhet në traktin C – 03).
 - **Site 4**, Përqendrim shumë i madh i qeramikës së periudhave helenistike, romake.
Ndodhet në fund të fshatit Drizë (traktet C – 47, C – 49, C – 50 dhe C – 51).
 - **Site 5**, Prezenca e një muri të palidhur me llaç dhe qeramikë e shpeshtë e periudhës së bronzit të mesëm.
(Ndodhet në traktin E – 05.)



AGJENCIA E
SHERBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Ruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

- **Site 6**, Përqendrime të shpeshta qeramike të periudhës së bronxit të mesëm.
(Ndodhen në traktet E – 16, E – 17 dhe E – 18).
 - **Site 7**, Shumë fragmente tjegullash të shpërndara në një sipërfaqe prej afërsisht 400 m², si dhe mbi bazën e literaturës mendohet se kemi të bëjmë me një vilë fshatare helenistike. (Ndodhet në traktin F – 09).
 - **Site 8**, Përqendrim i madh me fragmente qeramike të periudhës së bronxit, qeramikë helenistike dhe romake, mendohet se kemi të bëjmë edhe me një furrë për pjekjen e qeramikës. (Ndodhen në traktet F – 16, F – 17, dhe F – 18).
- III.** Raporti përfundimtar i sondazheve arkeologjikë do të miratohet në KKA.
- IV.** Kryerjen e gërmimeve arkeologjikë të shpëtimit në traktet e përcaktuara gjatë vëzhgimit intensiv arkeologjik, si më poshtë:
- **Site 1, Tuma e Cerujës,**
 - **Site 9**, Mbetjet e Këmbës apo shpatullës së një ure mesjetare në fshatin Nikollarë. (Ndodhet në traktin G – 51).
 - **Site 10, Tuma e Çekinit.**
Ndodhet në perëndim të fshatit me të njëjtin emër pikërisht në varrezat moderne të fshatit. Kjo tumë nuk preket realisht nga përblyja e HEC Banjë por është shumë pranë saj. Ajo rrezikohet nga ndërhyrja e paautorizuar e njerëzve si dhe nga hapja e varreve të reja.
 - Si edhe ato site që do të rezultojnë të nevojshme pas sondazheve arkeologjikë të cituara më sipër.
- V.** Raporti përfundimtar i gërmimeve arkeologjike të shpëtimit do të kalojë për miratim në KKA.
- VI.** Sondazhet do të kryhen nga ASHA me konsulencë shkencore nga IA/QSA.
- VII.** Gërmimet arkeologjike të shpëtimit do të kryhen me miratimin e KKA.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

- VIII. Objektet arkeologjikë të nxjerra gjatë sondazheve dhe gërmimit arkeologjik të shpëtimit do të depozitohen në fondet e IA dhe DRKK-ve. Për objektet që do të vendosen të ekspozohen do të merret miratim nga KKA.
- IX. Të kryhet mbikëqyrja arkeologjike gjatë ndërtimit të infrastrukturës ndihmëse (rrugë, karriera, etj.).
- X. Shpenzimet për kryerjen e sondazheve dhe gërmimeve arkeologjikë të shpëtimit, transportin e gjetjeve dhe botimin do të mbulohen nga investitori "Devoll Hydro Power" sh.a. në përputhje me kontratën koncesionare.
- XI. Afati i përfundimit të procesit të gërmimeve arkeologjike të shpëtimit do të jetë përpara fillimit të procesit të përblytjes në funksion të ndërtimit të HEC-eve në Kaskadën e Lumit Devoll.
- XII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

MINISTËR

NBn

SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI

ROLAND OLLI



AGJENCIJA E
SERVISIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al